



Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit politik dhe  
diskursi deliberativ  
Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian

## Indeks për monitorim të cilësisë së debatit në Kuvend

### Informacione themelore dhe për folësit

1. Data
2. Mënyra në të cilën përcillet seanca (nga galeria në Kuvend, drejtpërdrejtë përmes kanalit televiziv, përmes incizimit, stenogramit.
3. Titulli i komisionit ose seancës plenare.
4. Tema/pika nga rendi i ditës rreth të cilës bëhet debati .
5. Mënyra në të cilën shqyrtohet ligji – normale, e shkurtuar, urgjente.
6. Për folësin (deputetin) në mënyrë të veçantë shënohen inicialet, partia, përkatësia etnike, shkalla e arsimimit, partia, pozita ose opozita, njësia zgjedhore nga e cila është zgjedhur deputeti.
7. Për folësin (anëtarin e jashtëm) shënohen inicialet, institucioni të cilin e prezanton, seksin.

#### I. Argumentimi

Lëndë e analizës është çdo akt i veçantë i të folurit (fjalim, replikë, kundër-replikë) të deputetëve në sallën dhe ato të anëtarëve/përfaqësuesve të jashtëm (komision ose seancë plenare)

1. **Shkallë e arsytimit/justifikueshmërisë së argumenteve** – shënohet se sa folësi fjalimin/deklarimin e vet e arsyeton/mbështet me argumente.
  - 1) Nuk ka arsyetim – kur folësi nuk prezanton kurrfarë argumente (për shembull vetëm kërkon informacione shtesë ose vetëm vërteton/mohon duke mos dhënë kurrfarë arsytimi).
  - 2) Arsyetim i dobët – folësi vetëm thotë se diçka është dashur ose nuk është dashur të ishte bërë, se është ide e mirë ose e keqe...por nuk sqaron përse është dashur kjo të bëhet.
  - 3) Një arsyetim – folësi jep arsyetim/shkak të gjerë përse duhet/nuk duhet të bëhet ose përse diçka është e mirë apo e keqe.



Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit politik dhe  
diskursi deliberativ  
Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian

- 4) Dy dhe më tepër arsytetime – folësi jep më së paku dy shkaqe/arsytetime përse diçka duhet/nuk duhet të bëhet ose përse diçka është mirë apo keq.
2. **Përfshirja e arsytimit** – shënohet se në dobi të kujt apo në emër të kujt thirret folësi në fjalimin.
- 1) Neutral – ju bën vështrim përfitimeve ose pasojave të ndonjë grupi/partie.
  - 2) Të grupit të vet – ju bën vështrim përfitimeve ose pasojave të grupit/partisë/bashkësisë etnike të vetin.
  - 3) Grupe të tjera – ju bën vështrim përfitimeve ose pasojave për grupet/partitë/bashkësitë etnike e tjera.
  - 4) Për të mirën e përgjithshme - ju bën vështrim përfitimeve ose pasojave për të gjithë në shoqërinë.
  - 5) Parime abstrakte – thirret në parime abstrakte si drejtësi sociale, liri, paqe, cilësia e jetës, barazi...
3. **Përgjegjësi** – shënohet nëse folësi në fjalimin e vet jep ose kërkon përgjigje ose sqarim për ata ose nga , kryetar, qytetarë, grupe, publiku...).
- 1) Folësi nuk jep/kërkon përgjigje/sqarim nga ata të cilëve u ja ka drejtuar fjalimin.
  - 2) Folësi jep/kërkon përgjigje/sqarim nga ata të cilëve u ja ka drejtuar fjalimin.
4. **Fuqia e argumentit më të mirë** – shënohet nëse argumentet e dhëna në debatin ndikojnë në atë që folësit ti ndryshojnë pozitat/qëndrimet e veta me të cilat janë paraqitur në debatin.
- 1) **Nuk ka referencë.** Folësi aspak nuk ju bën vështrim argumenteve e paraqitura nga të tjerët.
  - 2) **Ndryshim i pozicionit për shkak të argumenteve.** Folësi vë në pah ndryshimin e pozicionit, ndërsa si shkak për ndryshimin arsyeton se janë në pyetje argumentet e prezantuara në debatin.



Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit politik dhe  
diskursi deliberativ  
Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian

- 3) **Ndryshim i pozicionit, por jo për shkak të argumenteve.** Folësi vë në pah ndryshimin e pozicionit, por si shkak nuk i vë në pah argumentet e prezantuara në debatin.
  - 4) **Nuk ka ndryshim të pozicionit, por e pranon vlerën e argumenteve.**  
Folësi mbetet në pozicionin e vet, por e njih vlerën e qëndrimeve të shfaqura në debatin.
  - 5) **Nuk ka ndryshim të pozicionit, nuk e pranon vlerën e argumenteve.**  
Folësi nuk e ndryshon pozicionin dhe nuk e njih vlerën e qëndrimeve të tjera të prezantuara në debatin.
5. **Përralla** – shënohet se folësi qëndrimet/pozicionet e veta i ekspozon përmes përrallës, dëshmisë së dikujt, anekdotës, barsuletës...
- 1) Nuk ka përrallë.
  - 2) Ka përrallë, ndërlidhet me argument.
  - 3) Përralla është i vetmi arsyetim.
  - 4) Përralla e ndërlidhur me argument e fuqizon arsyetimin racional
6. **Raporti ndaj pjesëmarrësve të tjerë** – shënohet nëse folësi në fjalimin e vet shfaq respekt ndaj pjesëmarrësve të tjerë në debatin.
- 1) Nuk ka referencë. Folësi nuk shfaq asgjë në fjalimin e vet në raport me folësit e tjerë.
  - 2) Mosrespektim. Folësi në fjalimin e vet drejton sulme dhe fyerje personale dhe partiake.
  - 3) Mosrespektim i pjesshëm. Folësi në pjesën më të madhe të fjalimit të vet drejton sulme dhe fyerje personale dhe partiake, por në një pjesë më të vogël ka raport neutral ose shfaq respekt ndaj pjesëmarrësve të tjerë.
  - 4) Respektim i pjesshëm. Folësi në pjesën më të madhe të fjalimit ka raport neutral ndaj pjesëmarrësve të tjerë ose drejton lëndata personale dhe partiake, në një pjesë më të vogël drejton sulme dhe fyerje partiake ndaj pjesëmarrësve të tjerë.
  - 5) Respektim. Folësi shfaq respektim themelor ndaj pjesëmarrësve të tjerë.
  - 6) Respekt eksplicit. Folësi drejton lëndata personale ose partiake ndaj pjesëmarrësve të tjerë.



Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit politik dhe  
diskursi deliberativ  
Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian

7. **Raporti ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të tjerë** – shënohet raporti i folësit ndaj argumenteve/kundër-argumenteve dhe aktiviteteve të deputetëve të tjerë:
- 1) Nuk ka referencë. Folësi me asgjë nuk i përmend pjesëmarrësit e tjerë.
  - 2) Mosrespektim. Folësi drejton sulme dhe fyerje personale dhe partiake ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të tjerë.
  - 3) Mosrespektim i pjesshëm. Folësi në pjesën më të madhe të fjalimit të vet drejton sulme dhe fyerje personale dhe partiake ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të tjerë, por në një pjesë më të vogël ka raport neutral ose shfaq respekt ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të tjerë.
  - 4) Respektim i pjesshëm. Folësi në pjesën më të madhe të fjalimit ka raport neutral ndaj pjesëmarrësve të tjerë ose drejton lëvdata personale dhe partiake ndaj argumenteve, por pjesën më të vogël drejton sulme dhe fyerje partiake ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të tjerë.
  - 5) Respektim. Folësi shfaq respektim themelor ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të tjerë
  - 6) Respekt eksplicit. Folësi drejton lëvdata personale ose partiake për argumentet ose aksionet e pjesëmarrësve të tjerë.
8. **Përdorim i fjalimit të pahijshëm** – shënohet nëse folësi përdor gjuhë të pahijshme, gjuhë fyese (të llojit “ju jeni gënjeshtar”, “prostitutë politike” e të tj....) për ti sulmuar pjesëmarrësit të tjerë dhe argumentet e tyre:
- 1) Nuk ka fjalor të pahijshëm/fyes/pa sjellshëm.
  - 2) Ka fjalor të pahijshëm/fyes/pa sjellshëm ndaj personit.
  - 3) Ka fjalor të pahijshëm/fyes/pa sjellshëm ndaj argumenteve.
  - 4) Fjalor i urrejtjes, folësi përdor gjuhë të urrejtjes, folësi përdor gjuhë me të cilën i fyen, folësi përdor gjuhë me të cilën i përbuz, degradon kundërshtarët e tij në bazë të përkatësisë së tyre politike, etnike, fetare, seksuale....
9. **Ndërprerje** – shënohet çdo ndërprerje e fjalimit të folësit e cila zgjat më gjatë se disa sekonda (5-8 sek.), këtu hyjnë hedhje e fjalëve, ndërhyrje nga vendi ku është i ulur...



Kuvendi nën thjerrëz, përforsimi i debatit politik dhe  
diskursi deliberativ  
Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian

- 1) Nuk ka ndërprerje. Këtu hyjnë të gjitha fjalimet në të cilat nuk ka kurrfarë ndërprerje duke e përfshirë edhe fjalimi që është ndërprerë për një kohë të shkurtër (nëse ndërprerja zgjat jo më shumë se disa sekonda
  - 2) Ka ndërprerje. Kur folësi është ndërprerë nga deputet tjetër, e me këtë rast ndërprerja zgjat më shumë se disa sekonda (mbi 8 sek.). Me këtë rast, nëse ndërprerja zgjat më gjatë dhe nuk kufizohet vetëm në hedhje të fjalëve duhet të konsiderohet si fjalim i ndarë.
10. **Gjestikulime dhe të folurit e trupit** – shënohet nëse folësi përdor gjestikulime për përkrahje të fjalimit të vet dhe nëse me ato eventualisht ju dërgon mesazh të pranishmëve.
- 1) Nuk gjestikulon. Folësi flet në mënyrë të qetë nga vendi ose foltorja edhe me duart dhe trupin nuk bën kurrfarë gjestikulime.
  - 2) Gjestikulon në favor të fjalimit.
  - 3) Gjestikulon ndaj të pranishmit e tjerë në seancën.
  - 4) Gjestikulon në mënyrë fyese ndaj të pranishmëve në seancën (kur në mënyrë eksplicite mund të vërehet se folësi në mënyrë të padyshimtë gjestikulon në mënyrë fyese ndaj të pranishmëve).
  - 5) Fjalimin e plotëson me gjestikulim dhe të folurin e trupit të cilat përfshijnë prezantim të .... (të shënohet me çka – fanellë me mesazh politik, pan-kartë, afishe, fotografi, dokument, send...).
11. **Pyetje - Kufizim** – shënohet nëse folësi vë në pah në mënyrë verbale ose me të folurin e trupit dhe shihet qartë se është i kufizuar/penguar nga sjellja e pjesëmarrësve të tjerë (ndërprerje, biseda private, grimasa, hapje e gojës me zë sikur i ka ardhur gjumi, kërcënime, kërcënime fizike, pengim fizik)
- 1) Nuk ka kufizim. Folësi flet lirshëm, pa kurrfarë kufizime.
  - 2) Folësi vë në pah ose tregon se është i penguar nga sjellja e pakulturuar e pjesëmarrësve të tjerë (ndërprerje, biseda private, grimasa, hapje e gojës me zë sikur i ka ardhur gjumi)
  - 3) Ndërprerje fizike. Kur folësi vë në pah ose duket se është fizikisht i ndërprerë nga pjesëmarrës tjetër (i është marrë mikrofoni, në mënyrë të dhunshme është dëbuar nga salla, rrahje, një grup deputetësh janë grumbulluar rreth foltores, brohoritje e zëshme, këndim me zë)
  - 4) Ndërprerje pasive. Kur deputetët në sallën nuk përpiqen në mënyrë aktive ta pengojnë fjalimin (fizikisht ose verbalist), por bartin ose nxjerrin pan-karta, fanella me mesazhe, simbole, fletë, sende, kafshë.... me çka përpiqen të ndikojnë në debatin



---

Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i  
debatit politik dhe  
diskursi deliberativ  
Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian

12. Shënohet kohëzgjatja e fjalimit